



LETRA ENCIKLIKE

FRATELLI TUTTI

E Atit të Shenjtë Françesku

Mbi vëllazërimin dhe miqësinë shoqërore

ÇFARË ËSHTË?



Enciklika e tretë e Papës Françesku, pas *Lumen fidei* (2013) e *Laudato si'* (2015).



U nënshkrua më 3 tetor 2020 në Asizi.

MBI ÇFARË BAZOHET?



- ▶ Çështje lidhur me vëllazërimin dhe miqësinë shoqërore, që kanë qenë objekt shqetësimi për Atin e Shenjtë gjatë viteve të fundit.
- ▶ Temat e paraqitura në *Dokumentin mbi vëllazërimin njerëzor për paqen botërore dhe mbi bashkëjetesën*, nënshkruar me Imamin e Madh Ahmad Al-Tayyeb në shkurt 2019.

ÇFARË PROPOZON?



- ▶ Është një enciklikë shoqërore kushtuar vëllazërimit dhe miqësisë shoqërore.
- ▶ Ndalet në përmasën universale të doktrinës mbi dashurinë vëllazërore.
- ▶ Të reflektojmë për të reaguar me një ëndërr të re vëllazërimi dhe miqësie shoqërore.
- ▶ Të ëndërrojmë si një njerëzim i vetëm, si udhëtarë bërë prej të njëjtit mish e gjak.

KUJT I DREJTOHET?



Të gjithë njerëzve, që e kthejnë këtë reflektim në hapje për dialog.

NGA RRJEDH TITULLI?



- ▶ *Fratelli tutti* është shprehje e Shën Françeskut të Asizit (*Admoniciones*, 6, 1).
- ▶ Shenjti e përdorte për të propozuar një formë jete me shijen e Ungjillit.
- ▶ Shën Françesku i fton të gjithë burrat dhe gratë për një dashuri, që shkon përtej gjeografisë dhe hapësirës.



LUTJE E KRISHTERË EKUMENIKE

“Eja o Shpirt i Shenjtë! Tregona bukurinë tënde pasqyruar në gjithë popujt e tokës, për të zbuluar se të gjithë janë të rëndësishëm, se të gjithë janë të nevojshëm, se janë fytyra të ndryshme të po atij njerëzimi të dashur prej Zotit”.

Amen

SI ËSHTË E ORGANIZUAR ENCIKLIKA?

- ▶ *Fratelli tutti* përbëhet nga një hyrje e përgjithshme dhe nga tetë kapituj.

Hyrja

Kapitulli I: Hijet e një bote të mbyllur

Kapitulli II: Një i huaj në rrugë

Kapitulli III: Të mendojmë dhe të krijojmë një botë të hapur

Kapitulli IV: Një zemër e hapur për mbarë botën

Kapitulli V: Politika më e mirë

Kapitulli VI: Dialogu dhe miqësia shoqërore

Kapitulli VII: Udhë për një takim të ri

Kapitulli VIII: Fetë në shërbim të vëllazërimit në botë


HIJET E NJË BOTE TË MBYLLUR 

*Papa Françesku vëren prirjet,
që e dëmtojnë vëllazërimin
universal*

**“Shoqëria gjithnjë e më e globalizuar
na afron, por nuk na bën vëllezër”**

**CILAT JANË
ASPEKTET, NË TË
CILAT VËREHEN
HIJET E NJË BOTE
TË MBYLLUR?**

- ▶ Mungesa e shpresës dhe mosbesimi i përhapur në shoqëri.
- ▶ Polarizimet, që nuk e ndihmojnë dialogun dhe bashkëjetesën.
- ▶ Njerëzit, që duken “të sakrifikueshëm” e mënjanohen.
- ▶ Pabarazia e të drejtave dhe format e reja të skllavërisë.
- ▶ Përkeqësimi i etikës dhe dobësimi i vlerave shpirtërore.



**SOT VËREJMË MANIPULIMIN
E FJALËVE TË RËNDËSISHME:**

**LIRI DREJTËSI
DEMOKRACIUNITET**

PARA GJITHË KËSAJ, FRATELLI TUTTI DËSHMON SE
“udha është afërsia dhe kultura e takimit”



Zoti vazhdon të dikojë
mbi njerëzimin farën e
së mirës.



E mira, dashuria, drejtësia
dhe solidariteti duhen
arritur çdo ditë.



Shpresa di të shohë përtej
rehatisë, që na kap në kurth,
për t'u hapur drejt idealeve
të mëdha.



NJË I HUAJ NË RRUGË



CILËT JANË PROTAGONISTËT E TJERË TË PRANISHËM NË SHËMBËLLTYRËN E SAMARITANIT TË MIRË?

- ▶ KUSARËT
- ▶ ATA QË VAZHDOJNË RRUGËN
- ▶ NJERIU I BRAKTISUR DHE I PLAGOSUR

Para kësaj situate, *Fratelli Tutti* na pyet:



Me kë identifikohesh?
Kush është i afërmi yt?

“Jezusi nuk na thotë të pyesim kush është pranë nesh, por t’i qëndrojmë pranë”.

SOT, HISTORIA E SAMARITANIT TË MIRË PËRSËRITET:

- 1 Determinizmi, ose fatalizmi pretendon të justifikojë indiferencën.
- 2 Shoqëria priret të mos interesohet për të tjerët.
- 3 Bota lejon përjashtimin.
- 4 Vërejmë një moskokëçarje shoqërore dhe politike.

Fratelli Tutti na nxit të jemi pjesë aktive e rehabilitimit të shoqërive të lënduara.

Dashurisë nuk i intereson nëse vëllai i lënduar vjen prej këtej apo prej andej:



DASHURIA THYEN ZINXHIRË DHE NDËRTON URA.

KALON MË TEJ APO NDALESH PARA TË PLAGOSURVE PËRGJATË UDHËS?

Përballë kaq shumë dhimbjeje, kaq shumë plagësh, rrugëdalja e vetme është të jesh si Samaritani i Mirë.

TË MENDOJMË DHE TË KRIJOJMË NJË BOTË TË HAPUR 

Jezusi thoshte: "Ju jeni të gjithë vëllezër" (Mt 23:8)

**Thirrja për vëllazërim
universal përfshin
hapjen:**

- ▶ Njeriu gjen plotësinë e vetvetes duke ia dhuruar atë të tjerëve.
- ▶ Dashuria kërkon një aftësi më të madhe për t'i mirëpritur të tjerët, duke integruar periferitë.
- ▶ Dashuria, që shtrihet përtej kufijve ka në bazë "miqësinë shoqërore".



**TË PROMOVOSH TË MIRËN DO TË THOTË TË PROMOVOSH VLERAT,
QË ÇOJNË DREJT NJË ZHVILLIMI NJERËZOR TË GJITHANSHËM**

Si mund
të arrihet
kjo?

- ✓ Duke menduar e duke vepruar si bashkësi.
- ✓ Duke luftuar kundër shkaqeve strukturore të varfërisë e të pabarazisë.
- ✓ Duke kërkuar një shtet të pranishëm e aktiv, që investon në favor të njerëzve të brishtë.
- ✓ Duke u siguruar që askush të mos përjashtohet.
- ✓ Duke arritur një paqe të qëndrueshme, nisur nga etika globale e solidaritetit dhe e shërbimit.

Çdo njeri është i çmuar dhe ka të drejtë të jetojë me dinjitet.



NJË ZEMËR E HAPUR PËR MBARË BOTËN



CILAT JANË MASAT, QË ÇOJNË NË VËLLAZËRIMIN UNIVERSAL?

1

T'i presim, t'i mbrojmë, t'i promovojmë dhe t'i integrojmë migrantët dhe gjithë të mënjanuarit.

2

Të rritet vetëdija se, ose shpëtojmë të gjithë bashkë, ose nuk shpëton askush.


3

Të kërkojmë një rend botëror juridik, politik dhe ekonomik, që priret drejt zhvillimit solidar të gjithë popujve.

Çfarë është dhurimi falas?

- ▶ T'i bësh gjërat, sepse janë të mira në vetvete.
- ▶ Të veprosh pa shpresuar të nxjerrësh ndonjë përfitim, ose të marrësh diçka si shkëmbim.
- ▶ Të përfshihen të gjithë të huajt, jo vetëm ata, që sjellin përfitime të dukshme.

"Cilësia e vërtetë e vendeve të ndryshme të botës matet me aftësinë për të menduar edhe si familje njerëzore. Zoti jep gjithnjë falas".



Çdo kulturë e shëndoshë është, për natyrën e saj, e hapur dhe mikpritëse:

Hapja e mendjes dhe e zemrës na ndihmon ta kuptojmë atë, që është i ndryshëm nga ne.

Në bashkimin universal, çdo grup njerëzor gjen bukurinë e vet.

Njeriu është qenie e kufizuar, që nuk ka kufi.

A është e mundur aftësia për t'ia hapur zemrën të afërmit në një familje kombesh?



POLITIKA MË E MIRË



"Dashuria, sipas mësimëve të Jezusit, është sinteza e gjithë Ligjit" (shih Mt 22,36-40)

Në çfarë konsiston politika e mirë?

- ▶ Vendoset në shërbim të së mirës së përbashkët.
- ▶ Nuk përpiqet veç të garantojë vota për vete.
- ▶ Favorizon mjete për zhvillimin personal.
- ▶ Promovon një ekonomi, që favorizon larminë prodhuese dhe krijimtarinë e sipërmarrjes.
- ▶ Mendon me mendje të hapur dhe përfshin dialogun ndërdisiplinor.

FRATELLI TUTTI FTON PËR NJË REND SHOQËROR E POLITIK, SHPIRTI I TË CILIT ËSHTË DASHURIA SHOQËRORE:

- ✓ Na lejon të ecim përpara drejt qytetërimit të dashurisë, për të cilin jemi të gjithë të thirrur.
- ✓ E konsideron çdo njeri si vëlla ose motër, duke përfshirë të gjithë.
- ✓ Dashuria ka nevojë për dritën e së vërtetës, që është edhe ajo e arsyes dhe e fesë.



"Dashuria shoqërore na bën ta duam të mirën e përbashkët dhe të kërkojmë me të vërtetë të mirën e gjithë njerëzve, në përmasën shoqërore, që i bashkon".

Në veprimtarinë politike, çdo njeri është i shenjtë dhe meriton dashurinë e përkushtimin tonë:


"Nëse arrin të ndihmohet edhe një njeri të vetëm të jetojë më mirë, kjo është më se e mjaftueshme për të justifikuar dhuratën e jetës tënde".



DIALOGU DHE MIQËSIA SHOQËRORE

Ç'do të thotë "dialog"?

- ▶ TË AFROHEMI
- ▶ TË SHPREHEMI
- ▶ TË DËGJOHEMI
- ▶ TË SHIHEMI
- ▶ TË NJIHEMI
- ▶ TË PROVOJMË TË KUPTOHEMI
- ▶ TË KËRKOJMË PIKA TAKIMI



SIPAS KULTURËS SË TAKIMIT:

nga të gjithë mund të mësojmë diçka, askush s'është i padobishëm, askush s'është i tepërt.

NJË SHOQËRI PLURALISTE, QË FTON PËR DIALOG:

- 1 Respekton, në çdo situatë, dinjitetin e tjetrit.
- 2 Integron realitete të ndryshme, duke garantuar paqen e vërtetë e të qëndrueshme.
- 3 I njeh tjetrit të drejtën të jetë vetvetja, duke përdorur sërish mirësinë.



Cilat janë qëndrimet, ose faktet, që nuk e ndihmojnë dialogun?

- ▶ Agresiviteti, që mund të arrijmë ta shfaqim, për shembull, në rrjetet shoqërore.
- ▶ Monologu, që nuk ndalet për të dëgjuar tjetrin.
- ▶ Diskreditimi i menjëhershëm, duke e poshtëruar tjetrin.

Dialogu i vërtetë shoqëror presupozon aftësinë për të respektuar pikëpamjet e tjetrit.



UDHËT E TAKIMIT TË RI



NË RRUGËTIMET DREJT PAQES, JANË MË SE TË NEVOJSHME PROCESET PËR NJË TAKIM TË PËRTËRIRË:

✓
Në pajtimin e vërtetë.

✓
Në projektin e përbashkët, që nuk e zhbën individin.

✓
Në njohjen, garantimin dhe arritjen e dinjitetit të gjithë njerëzve.

✓
Në opcionin për më të varfërit, më të fundmit, më të mënjanuarit.

✓
Në vlerësimin dhe në kuptimin e domethënies së faljes.




Kurrë, Jezu Krishti nuk ka ftuar të nxitet dhuna, ose intoleranca.

Ungjilli na kërkon të falim “shtatëdhjetë herë shtatë” (Mt 18,22)

FALJA E VËRTETË DHE PAJTIMI I VËRTETË:

- ▶ Fitohen në konflikt, duke e kapërcyer atë, përmes dialogut.
- ▶ Heqin dorë nga aktet e armiqësisë dhe të urrejtjes për njëri-tjetrin.
- ▶ Lehtësojnë diskutimin e ndershëm, bazuar mbi dashurinë për drejtësinë.
- ▶ Nuk përfshijnë harresën, ose mosndëshkimin.
- ▶ Nuk bien në rrethin vicioz të hakmarrjes.



“I lutem Zotit të na i përgatisë zemrat për takimin me vëllezërit, pavarësisht nga ndryshimet në ide, gjuhë, kulturë, fe”

PAPA FRANÇESKU



FETË NË SHËRBIM TË VËLLAZËRIMIT NË BOTË



VETËM ME VETËDIJEN E BIJVE MUND TË JETOJMË NË PAQE NDËRMJET NESH:

Fetë e ndryshme japin një kontribut të çmuar për arritjen e vëllazërimin.

Kërkimi i Zotit na ndihmon ta shohim njëri-tjetrin si shokë udhe: si vëllazër.

Mohimi i lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë e varfëron njerëzimin.



KISHA ËSHTË SHTËPI ME DYER TË HAPURA, SEPSE ËSHTË NËNË:

1

Ndërton
ura

2

Shemb
mure

3

Mbjell
pajtim

ËSHTË E MUNDUR NJË UDHË PAQEJE NDËRMJET FEVE:

- ▶ Pikënisja duhet të jetë vështrimi i Zotit, sepse Hyji sheh me zemër.
- ▶ Dhuna nuk ka baza në bindjet fetare.
- ▶ Kulti i Zotit, i sinqertë dhe i përvuajtur, çon në respektin për jetën, dinjitetin dhe lirinë.



LUTJE E KRISHTERË EKUMENIKE

O Zoti ynë, Trini dashurie,
nga bashkimi i fuqishëm i intimitetit tënd hyjnor
diko mes nesh lumin e dashurisë vëllazërore.
Na dhuro dashurinë, që dukej qartë nga gjestet e Jezusit,
në familjen e tij në Nazaret e në bashkësinë e parë të krishterë.

Bëj që ne të krishterët ta jetojmë Ungjillin
e ta njohim Krishtin në çdo njeri,
për ta parë të kryqëzuar në ankthin e të braktisurve
dhe të të harruarve të kësaj bote
e të ringjallur në çdo vëlla, që ngrihet në këmbë.

Eja, o Shpirt i Shenjtë! Tregona bukurinë tënde
pasqyruar në gjithë popujt e tokës,
për të zbuluar se të gjithë janë të rëndësishëm,
se të gjithë janë të nevojshëm, se janë fytyra të ndryshme
të po atij njerëzimi të dashur nga Zoti.
Amen.

**Krerët fetarë janë të
thirrur të jenë
"dialogues" të vërtetë:
të veprojnë, në arritjen e
paqes, si ndërmjetësues
të njëmendët.**